

Rinia Ortodokse Tirane: Pako ushqimore dashurie, Pashkë 2021



Edhe sivjet, me Hirin e Zotit të Ngjallur, me rastin e Pashkëve 2021, Zyra e Rinisë pranë Kryepiskopatës, për t'iu gjendur pranë njerëzve në nevojë, organizoi dhe përfundoi dy nisma bamirësie për familje në Gramsh, Gjinar dhe Zavalinë.

Kështu, nisma e parë e quajtur "Familjet Ortodhokse për familjet në nevojë" u organizua në formë binjakëzimi ndërmjet familjesh, ku familje në Tiranë, zgjedhën dhe kompletuan vetë pako ushqimore për një familje tjetër në Gramsh me ushqime bazë të shportës. Brenda një kohe fare të shkurtër, u kompletuan dhe u siguruan 37 pako ushqimore dhe dorëzimi i tyre u bë në banesat e familjeve përfituese të përzgjedhura me shumë kujdes nga përfaqësues të Zyrës së Rinisë me datë 16 Prill 2021.

Nisma e dytë, konsistoi në përgatitjen e 46 pakove ushqimore për familje të zonave të thella malore në Gjinar dhe Zavalinë të Elbasanit. Kjo nismë u mbështet

financiarisht nga besimtarë të ndryshëm nga brenda dhe jashte vendit. Pregatitja dhe shperndarja e pakove u krye me datë 22 Prill 2021 nga stafi i Zyrës së Rinisë duke bashkëpunuar me klerikë të Mitropolisë së Elbasanit.

Duke pasur parasysh situatën e vështirë financiare, falenderime të shumta shprehim për secilin dhuronjës që ndajnë kafshatën e tyre me persona të tjerë në vështirësi.

Zoti i Ngjallur dhe Drita e Ngjalljes, ndriçoftë dhe bekoftë duartë që dhurojnë dhe japin gëzim në sytë e atyre që vuajnë!

Jani Meni

— facebook.com/rinia.tirane